

SKRIPTA DITA E KOMBEVE TË BASHKUARA [NARRACIONI]

24 Tetori është Dita e Kombeve të Bashkuara. Më 1945, në këtë datë, Kombet e Bashkuara u themeluan zyrtarisht. Shumë njerëz në Kosovë dinjë për OKB-në. Ata e njohin flamurin ngjyrë qielli. Ata e shohin logon e OKB-së në makinat që kalojnë nëpër qytetet dhe fshatrat e tyre. Por çka në të vërtetë do të thotë OKB për një person të rëndomtë në Kosovë?

[PERSONAT NË RRUGË INTERVISTA NË GJUHË SHQIPE DHE SERBE]

INTERVISTUESI: Cfarë ju bie ndër mend kur dëgjoni OKB?

Menjëherë më shkon mendja tek krizat, ndonjë epidemi e madhe.

Ajo që më bie ndër mend më së pari janë shtetet ku ndodhin trazirat. OKB-ja është gjithmonë aty për të zgjidhur çështjet politike.

Kam mendim pozitiv për OKB-në si një organizatë por poashtu kam shumë kritika për punën e saj.

E shoh OKB-në si një familje e madhe, e cila për momentin është në gjendje konflikti.

Më kujtohet 1999-ta. Konflikti. Kombet e Bashkuara i kanë ndihmuar Kosovës, dhe kudo që ka kriza, ata janë aty për të intervenuar dhe shpëtuar popullatën.

INTERVISTUESI: Cfarë bën OKB-ja?

Nuk e di. Nuk jam e sigurtë.

OKB-ja është një organizatë që i bashkon shtetet e pavarura Mbron të drejtat e njeriut.

Merret me epidemi zgjidhje të konflikteve

Ndihma humanitare

INTERVISTUESI: Cilat vlera i mbron OKB-ja?

NJERËZIT NË RRUGË:

Për ndihmë. Ajo u ndihmon njerëzve.

Barazi cdokush duhet ta ketë të drejtën e barabartë për zhvillim dhe përparim.

OKB qëndron për unitetin në botë dhe përparimin ekonomik

Bota është shtëpia e jonë, dhe në atë shtëpi ka shumë shumë kombe dhe religjione por duhet të ketë rend poashtu, duhet të jenë disa rregulla. Ja se për çfarë qëndron OKB-ja.

[NARRATOR]

Farid Zarif është Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë.

[PSSP]

Organizata e Kombeve të Bashkuara është themeluar përafërsisht para shtatë dekadave. Por nuk është paraparë të jetë vetëm një institucion. Ka qenë një premtim solemn për njerëzit e botës. OKB është krijuar për të mbrojtur gjeneratat e ardhëshme nga fatëkeqësitë e luftërave, për të shpënë përpara të drejtat e njeriut, dhe për ta promovuar drejtësinë. Jemi ballafaquar me shumë pengesa të ndryshme prej gjenocidit dhe terrorizmit deri tek ndryshimet atmosferike dhe sëmundjet. Nuk është lehtë për një organizatë që të trajtojë çdo gjë prej trafikimit të njerëzve dhe korrupsionit, deri tek vërshimet dhe thatësitat. Por duhet të vazhdojmë të përpiqemi.

Jam krenar me atë që OKB-ja e ka arritur nëpër glob. Objektivat tona të Zhvillimit të Mijëvjeçarit na udhëhoqën drejt fushatave më të sukseshme kundër varfërisë. Tortura dhe racizmi janë ta ndaluar me ligj duke iu falenderuar traktateve të OKB-së.

Përafërsisht 120,000 paqeruajtës të OKB-së duke përfshirë ushtrinë, civilët dhe policinë janë të vendosur në 16 operacione nëpër 4 kontinente. Dhe, më shumë se 3,000 të punësuar të OKB-së duke përfshirë një Sekretar të Përgjithshëm dhe disa zyrtarë të lartë të OKB-së kanë vdekur duke i shërbyer paqes.

OKB furnizon me ushqim 90 milionë njerëz në 80 shtete. Ne vaksinojmë përafërsisht 60 për qind të fëmijëve të botës dhe promovojmë shëndetin e nënës, duke shpëtuar më shumë se 30 milionë jetë në vit.

OKB ndihmon pothuaj 40 milionë refugjatë dhe njerëz të ikur nga lufta, uria dhe persekutimi. Ne ndihmojmë diku 60 shtete në vit me zgjedhjet. Ndërmjetësuesit tanë kanë zgjedhur mosmarrëveshjet përgjithmonë. Dhe marrëveshjet e OKB-së për ambientin mbrojnë oqeanet, ajrin dhe tokën tonë.

[NARRATOR]

OKB punon për të adresuar sfidat gjithandej globit dhe kjo përfshin Kosovën. Ekipi i OKB-së për Kosovë përbëhet prej 21 bashkësive të OKB-së dhe atyre ndërkombëtare. Ato ofrojnë mbështetje për Kosovën në mënyrë që ajo të mund të përmbushë më mirë nevojat e saja zhvillimore. Ekipi është i specializuar në një numër fushash të rëndësishme, duke përfshirë shëndetësinë, arsimin, të drejtat e njeriut, fuqizimin e grauas, bujqësinë dhe punësimin. Ekipi i OKB-së për Kosovë udhëhiqet nga Koordinatori për Zhvillim, Andrew Russell.

[ANDREW RUSSELL]

Ne jemi me të vërtetë të përcëndruar në atë që e quajmë zhvillim njerëzor, dhe zhvillimi njerëzor ka të bëjë me sigurimin që i gjithë populli i Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre, prej nga vijnë, kush janë çfarë gjuhe flasin, çfarë religjioni praktikojnë, të kenë përparësitë e barabarta në gjenerimin e të ardhurave dhe të kenë jetë të shëndoshë dhe shpresojmë, të lumtur.

Ne përcëndrohemi në tri fusha të prioriteteve. E para është zhvillimi gjithëpërfshirës, i çëndrueshëm, që gjeneron vende të punës, punësim për Kosovarët, psaçërisht për më të cënuarit: gratë, rininë

Përcëndrimi i ynë i dytë është qeverisja dhe sundimi i ligjit. Kjo punë është akoma në process e sipër këtu në Kosovë. Dhe i treti, mendoj se të gjithë ne jemi shumë të vetëdijshëm për ndikimin e këtuashëm negativ të ambientit në shëndet. Ka ende punë për tu bërë sa i përket fuqizimit të kapaciteteve të sistemit të shëndetësisë.

Dhe në fund, ju keni ca ligje shumë të mira në fuqi. Sfida tani në Kosovë mbetet kapaciteti për të zbatuar. Kështu që shumë prej programeve tona në të ardhmen do të jenë të përqëndruara për të ndihmuar Kosovën që të zhvillojë siteme të llogaridhënies, kontrollit dhe balansimeve, për shembull monitorimi i ligjeve dhe zbatimi i tyre nga shoqëria civile mënyra të tjera për tu siguruar që korniza e mrekullueshme ligjore që tashmë ekziston në Kosovë, të fillojë me të vërtetë të shërbejë nevojave të popullit të Kosovës.

[NARATOR]

OKB është duke u angazhuar në terren në Kosovë. Por Dita e OKB-së është poashtu ditë për tu kujtuar që Kosova është pjesë e një shoqërie më të gjërë, bashkësisë botërore.

[SRSG]

Ne nuk jemi në Kombe të Bashkuara vetëm për një vend pune. Ne jemi këtu për t i shërbyer një qëllimi, një qëllim i cili ka të bejë me fatin e gjithë njerëzimit. Në Ditën e Kombeve të Bashkuara, ne riafirmojmë përkushtimin tonë për t i fuqizuar të marginalizuarit dhe të pambrojturit. Dhe ne jemi të përkushtuar në realizimin e vizionit tonë për një jetë të dinjitetshme për të gjithë.